

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA E NOTERËVE ELBASAN  
NOTER ALMA L. LIMANI  
Nr. 838 REP dhe Nr.453 KOL



Elbasan, më: 17/02/2016.

### MARRËVESHJE PËR BARRË SIGURUESE DHE PENGU MBI AKSIONET E PJESËMARRJES NË SHOQËRI

Sot më 17/02/2016 (shtatembedhjete shkurt dymije e gjashtembedhjete), përpara meje noterit Alma L. Limani, anetare e Dhomes se Notereve Durres, me zyre ne lagjen "Aqif Pasha" Elbasan , u paraqiten personalisht palët e mëposhtme nëpërmjet përfaqësuesve të tyre:

#### BARRËMARRËSI

Shoqëria "Albametal" shpk, me NIPT L43402201R, me seli në adresën Lagjja 28 Nentori, bulevardi Qemal Stafa, pallati nr.109/1, shkalla 1, kati 2, Elbasan, me administrator te saj MIODRAG JANKOVIC, atesia Dragolub, perfaqësuar nepermjet prokures se per gjithshme nr.448 rep. e nr.122 kol. hartuar nga noter Blerta Kaceli me datë 09.07.2015, nga perfaqësuesi ALTIN HOXHA, atesia Nazif, lindur me 26.02.1978, identifikuar me leternjoftim nr.030096979, numer personal H80226006P, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, i autorizuar sipas ligjit për qëllimin e këtij transakzioni me Vendimin 16.02.2016 datë [●], i autorizuar ALTIN HOXHA, atesia Nazif, lindur me 26.02.1978, identifikuar me leternjoftim nr.030096979, numer personal H80226006P, në bazë të Vendimit të Asamblesë së Përgithëshme të Ortakëve të datës 15.02.2016 të kësaj shoqërie (këtu e më poshtë "Barrëmarrësi").

Dhe

#### Shoqëria:

Shoqëria "Kurum International" sha, një shoqëri me NIPT K02727230T me seli në adresën Rr. Ibrahim Rugova, pallati Green Park, kati 6, apartamenti 39, Tiranë, përfaqësuar nga administratori Z. YUSUF SEZAI KURUM, lindur me 10.08.1980, identifikuar me pasaporte turke nr.U01215069, numer personal 14489710138, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar, i autorizuar sipas ligjit për qëllimin e këtij transaksioni në lidhje me Vendimin e Asamblesë së Aksionarëve të shoqërisë datë [●]; i asistuar nga përkthyesi i gjuhës turke z.ELTON ASLLANI, atesia Zarif, lindur me 22.07.1981, pajisur me leternjoftim nr.032054447, numer personal I10722130W, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar (këtu e më poshtë "Shoqëria")

Dhe

#### BARRËDHËNËSI/PENGDHËNËSI:

- Z. Hasmet Bedii KURUM, shtetas shqiptar, i biri i Salim Sitki, lindur në Ercis/Turqi dhe banues në Tiranë, në adresën: Rruga "Jul Variboba" Nr. 1/21, mbajtës i pasaportës shqiptare me Nr. SI2754602 dhe Nr. Identifikimi Personal G01227031R, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, njëkohësisht dhe aksionar i vetëm i shoqërisë tregtare "Kurum International" SHA, i përfaqësuar me anë të prokurës së posaçme Nr. 255 REP dhe Nr.74/4 Kol datë 16.02.2016 të noterit Belinda Çelaj, nga z. Yusuf Sezai KURUM, mbajtës i pasaportës turke me nr U 01215069, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, i asistuar nga përkthyesi i gjuhës turke z. ELTON ASLLANI, atesia Zarif, lindur me 22.07.1981, pajisur me leternjoftim nr.032054447, numer personal I10722130W, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar (këtu e më pas "Barrëdhënësi" ose "Pengdhënësi").

*Notar*

*M. Manastirliu*

*D. Çelaj*

*Y. Sezai*

## KUSHTET PARAPRAKE:

(A) Sipas kushteve te Kontratës Kuadër të Furnizimit Nr.837 REP dhe Nr.452 Kol datë 17.02.2016 të noterit Alma L. Limani (me poshtë referuar si Kontrate Furnizimi), lidhur midis Shoqërisë "Kurum International" SHA dhe "ALBAMETAL" SHPK palët kanë përcaktuar detyrimet e ndërsjella ndërmjet tyre për sa kohë do të jetë në fuqi kjo kontratë.

(B) Si kusht paraprak për zbatimin e Kontratës së Furnizimit, palët kanë rënë dakord të lidhin këtë Marrëveshje Siguruese mbi aksionet e pjesëmarrjes në Shoqërinë "Kurum International" SHA, kështu;

Z Hasmet KURUM, është pronar i regjistruar i 100% të kapitalit të Shoqërisë "Kurum International" SHA, ose zotërues/pranar i 6.864.800 (gjashtë milionë e tetëqind e gjashtëdhjetë e katër mijë e tetëqind) aksioneve në shoqërinë "Kurum International" SHA.

(C) Si kusht paraprak për zbatimin e Kontratës së Furnizimit, Barrëdhënësi/Pengdhënësit kanë rënë dakord t'i vënë në dispozicion Barrëmarrësit (sic përkufizohen më poshtë) një Marrëveshje Siguruese mbi aksionet e pjesëmarrjes në shoqëri që barrëdhënësit zotërojnë aktualisht dhe do të zotërojnë në të ardhmen në kapitalin e Shoqërisë, në mënyrë që të sigurojë përbushjen e detyrimeve "Kurum International" SHA ka sipas Kontratës së Furnizimit

Është rënë dakord si më poshtë vijon:

### 1. INTERPRETIMI

#### 1.1 Kushtet paraprake dhe shtojcat

Kushtet paraprake dhe shtojcat e kësaj Kontrate përbëjnë pjesë themelore të saj, që janë të detyrueshme si për Palët, ashtu edhe për trashëgimtarët, si dhe të tretëve të cilëve mund t'u kalojnë te drejtat dhe/ose detyrimet e kësaj Marrëveshje.

#### 1.2 Përkufizime

Përveçse kur është parashikuar ndryshe në këtë Marrëveshje (qoftë specifikisht ose me reference), termat e përcaktuara në kontratat e ndërmjet palëve do të kenë të njëjtin kuptim në këtë Marrëveshje.

"Marrëveshje" do të thotë kjo Marrëveshje, sic mund te ndryshohet dhe/ose riformulohet herë pas here.

"Ligji i Zbatueshëm" do të thotë Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe ligje ose rregullore të tjera të Republikës së Shqipërisë, ne fuqi dhe të zbatueshme në çdo kohë dhe herë pas here për sa kohë që kjo Marrëveshje do të zbatohet.

"Kodi Civil" do të thotë Ligji Shqiptar Nr.7850, datë 29 Korrik 1994, me ndryshimet përkatese.

"Kodi i Procedurës Civile" do të thotë Ligji Shqiptar Nr. 8116, datë 29 Mars 1996, me ndryshimet përkatese.

"Kolateral" do të thote Aksionet të tashme dhe të ardhshme dhe të Drejtat e Lidhura me to;

"Rasti i Ekzekutimit të Detyrueshëm" do të thotë ndodhja dhe/ose vërtetimi i njëjës prej Rasteve të Mospërmbushjes së detyrimeve sipas Kontratës së Furnizimit.

"Ligji mbi barrët siguruese" do të thotë ligji shqiptar Nr. 8537 datë 18 tetor 1999, i ndryshuar;

"Barrë Siguruese" do të thotë barra siguruese e radhës së parë të referimit mbi Aksionet e vendosura në favor të Barrëmarrësit sipas nenit 2 (dy) të kësaj kontrate dhe sipas kontratave ndërmjet palëve të tjera.

"Peng" do të thotë pengu i radhës së parë të preferimit mbi Aksionet e vendosura në favor të Barrëmarrësit sipas nenit 2 (dy) të kësaj kontrate dhe sipas kontratave ndërmjet palëve;

"Regjistri i Barrëve Siguruese" mban kuptimin që i jepet në Ligjin Për Barrët Siguruese.



"Të drejta të lidhura me to" do të thotë

- (i) çdo divident ose interes i paguar ose i pagueshëm ne lidhje me aksionet;
- (ii) çdo aksion, letra me vlerë, të drejta, te holla ose pasuri të lindura ose të ofruara në çdo kohe (qofte me ane te kthimit, bonus, referimit, të drejtave me kusht, zëvendësimin, këmbimin ose ndryshe) ne lidhje me ose mbi cilëndo nga Aksionet;
- (iii) të gjithë dividentë, interesat ose te ardhura të tjera në lidhje me çdo aset të përmendur në paragrafin (ii) më lart; dhe
- (iv) të gjithë të drejtat e votës në lidhje me Aksionet, të cilat mund të ushtohen si në asamblenë e zakonshme, ashtu edhe në asamblenë e jashtëzakonshme të Shoqërisë, sipas Nenit 6 të kësaj Kontrate.

"Detyrimet" do të thotë:

- (i) të gjithë detyrimet monetare (dhe detyrimet të cilat mund të vlerësohen në të holla) dhe detyrimet e Shoqërisë kundrejt Barrëmarrësit sipas Kontratës së Furnizimit ndërmjet palëve; dhe.
- (ii) të gjithë detyrimet e Shoqërisë dhe të Pengdhënësve kundrejt Barrëmarrësit sipas kësaj Kontrate

"Aksionet" do të ketë kuptimin e përcaktuar më sipër në pikat (B) të kësaj Kontrate.

### 1.3 Interpretim

- (a) Në këtë Marrëveshje (si dhe ne te gjithë dokumentet e tjerë në lidhje me këtë Marrëveshje), përveçse kur qëllimi i përdorimit është dukshëm i ndryshëm, një referencë për:
  - (i) "akt normativ" përfshin çdo rregullore, rregull, urdhër zyrtar, kërkesa apo udhëzim (që mund të ketë ose jo fuqinë e ligjit) të çdo autoriteti qeveritar, agjencie, departamenti apo institucioni rregulator, vete-rregullues apo çdo lloj organizate apo autoriteti qeveritar;
  - (ii) "person" përfshin çdo individ shqiptar apo te huaj, çdo person juridik, firmë, Shoqëri, ortakëri, ent shtetëror ose joint-venture, dhe përfshin trashëgimtarët dhe personat të cilëve u kane kaluar të drejtat dhe detyrimet e kesaj Marrëveshje;
  - (iii) çdo nen, paragraf ose Shtojcë, përbën një reference për këtë Nen, paragraf apo shtojcë të kësaj Kontrate, përveçse kur është përcaktuar shprehimisht ndrysht;
  - (iv) "Palët", referohet bashkërisht palëve të kësaj kontrate.
- (b) Nëse kërkohet përbajtja, fjalët e përdorura në numrin njëjës përfshijnë edhe numrin shumës dhe anasjelltas, dhe fjalët e përdorura në një gjini përfshijnë të gjitha gjinitë.
- (c) Titujt në këtë Marrëveshje përdoren vetëm me qëllim orientimi.

## 2. OBJEKTI I MARREVESHJES

### 2.1 Krijimi i Pengut dhe i Barrës Siguruese

Pengdhënësi/Barrëdhënësi, si një garanci për shlyerjen e plotë dhe të pakthyeshme të Detyrimeve të Garantuara, me ane te këtij akti

- (i) në mënyrë të pakthyeshme jepin peng Aksionet në favor të Barrëmarrësit
- (ii) në mënyrë të pakthyeshme bien dakord për dhënien dhe krijimin e një Barre Siguruese mbi aksionet e pjesëmarres ne shoqëri dhe të drejtat e lidhura me to në favor të Barrëmarrësit, "ALBAMETAL" SHPK dhe çdo aksion i ri e Shoqërisë ose të drejtat e lidhura me ta që mund të zotërohen në të ardhmen nga Barrëdhënësit.

### 3. DETYRIMET E GARANTUARA

Pengu dhe Barra Siguruese e Barrëmarrësit jepen si garanci e radhës së parë për dhe deri në përbushjen e plotë dhe të pakushtëzuar të Detyrimeve te Përcaktuara në Kontratën e Furnizimit. As Penguin dhe as Barra Siguruese e Barrëmarrësve nuk do te reduktohen në asnë mënyrë për arsyet e shlyerjes së pënjesshme të Detyrimeve te Përcaktuara në Kontratën e Furnizimit.

### 4.KOMPLETIMI

(a) Barra Siguruese do të regjistrohet në Regjistrin e Barrëve Siguruese. Barrëdhënësit dhe Shoqëria "Kurum International" SHA, autorizojnë "ALBAMETAL" SHPK të nënshkruejë, dörözjojë, regjistrojë dhe të depozitojë çdo dokument te mëtejshëm që "ALBAMETAL" SHPK, konsideron të nevojshme dhe të duhur për kompletimin e Barrës Siguruese të krijuar sipas kësaj Kontratës.

(b) Sa më shpejt të jetë e mundur, por në çdo rast jo më pak se brenda 15 ditëve pune, duke filuar nga data e nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje, Shoqëria duhet të pajisë Barëmarrësin me Vendimin e Asamblesë së Aksionarëve që autorizon kriimin e pengut dhe barrës siguruese. Ky vendim depozitohet në Regjistrin Tregtar të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit dhe një ekstrakt zyrtar nga dosja tregtare e Shoqërisë "Kurum International" SHA që mbahet pranë Regjistrit Tregtar dhe provon regjistrimin e Pengut dhe të Barrës Siguruese do t'i dërgohet Shoqërisë "ALBAMETAL" SHPK.

(c) Pengdhënësi dhe Shoqëria "Kurum International" SHA, autorizojnë me anë të këtij akti, "ALBAMETAL" SHPK të nënshkruejë, kompletojë dhe regjistrojë të gjithë dokumentet e nevojshme që Barrëmarrësi i konsideron të nevojshme ose të përshtatshme. Pengdhënësit dhe Shoqëria "Kurum International" SHA, do të nënshkruanjë, kompletojnë, regjistrojnë, dërgojnë dhe depozitojnë të gjithë dokumentet e mëtejshme që Barrëmarrësi mund të kërkojë në mënyrë të arsyeshme për të realizuar qëllimet e kësaj kontrate, për të siguruar vazhdimësinë e pengut, për mbrojtjen dhe ruajtjen e Kolateralit dhe ekzekutimin e të drejtave të Barrëmarrësit sipas kësaj kontrate.

### 5. EKZEKUTIMI I PENGUT DHE/OSE I BARRES SIGURUESE

Me vërtetimin e një Rasti Ekzekutimi të Detyrueshëm dhe në çdo kohe paskëtaj, dhe në zbatim të dispozitave të kontratës së furnizimit "ALBAMETAL" SHPK ka, pa cenuar te drejtat e tjera ose rivendosjen në vend të tyre sipas ligjit ne fuqi, të gjithë të drejtat dhe mjetet e rivendosjes së të drejtave të parashikuara në Kodin Civil dhe në Ligjin për Barrët Siguruese.

### 6 TE DREJTAT E VOTES DHE DIVIDENDET


#### 6.1 Te drejtat e votës

Deri në vërtetimin e një Rasti të Ekzekutimit të Detyrueshëm, të drejtat e votës të lidhura me Aksionet, në asamblenë e zakonshme si dhe në asamblenë e jashtëzakonshme të Aksionarëve/Ortakëve të Shoqërisë, do të ushtrohen nga Pengdhënësit, me kusht që këto të drejta të mos ushtrohen nëasnë rast nga barrëdhënësit në një mënyrë të tillë që do të mund të cënonë vlefshmérinë dhe zbatueshmérinë e kësaj Kontrate dhe/ose e cila nuk është në përputhje me dispozitat e Kontratës së Furnizimit apo çdo kontrate tjetër të lidhur me të.

#### 6.2 Dividendet

Deri në vërtetimin e një Rasti Ekzekutimi të Detyrueshëm, Pengdhënësit kanë të drejtë të përfitojnë të gjithë dividendët që rrjedhin nga Aksionet.

#### 6.3 Vërtetimi i një Rasti Ekzekutimi të Detyrueshëm



(a) Me vërtetimin e një Rasti Ekzekutimi të Detyrueshëm, "ALBAMETAL" SHPK, do t'i dërgojë një njoftim barrëdhënësve dhe Shoqërisë "Kurum International" SHA, duke informuar se është vërtetuar një Rast i Ekzekutimit të Detyrueshëm dhe, gjatë kohëzgjatjes së Rastit të Ekzekutimit të Detyrueshëm dhe deri sa Barrëmarrësi të informojë Barrëdhënësin dhe Shoqërinë "Kurum International" SHA, me shkrim se Rasti i Ekzekutimit të Detyrueshëm ka pushuar se ekzistuari, Barrëdhënësi ka të drejtë por nuk është i detyruar që:

- (i) të ushtrojë të drejtat e votës qe lidhen me Aksionet, në Asamblenë e Zakonshme dhe në Asamblenë e Jashtëzakonshme të aksionareve/ortakëve të Shoqërisë "Kurum International" SHA, dhe
- (ii) të përfitojë të gjithë dividentët që lidhen me Aksionet. Dividendët e përfituar në këtë mënyrë nga Barrëmarrësi do përdoren për shlyerjen e Detyrimeve të Siguraura të mospërmbushura deri në atë datë. Barrëmarrësi do të ketë titull të veçantë menjëherë të ekzekutueshëm për të përfituar në mënyrë të drejtpërdrejtë nga Shoqëria "Kurum International" SHA të gjithë dividentët ose pagesat e tjera në përputhje me Nenin 550 të Kodit Civil dhe Nenit 30 te Ligjit për Barrët Siguruese.

(b) Në lidhje me të drejtat e Barrëmarrësit sipas paragrafit (a) të këtij neni 6, Barrëdhënësit dhe Shoqëria "Kurum International" SHA, heqin dore nga çdo kërkim, veprim, mbrojtje, përjashtim apo kundër padi lidhur me ushtrimin nga ana e Barrëmarrësit të të drejtave të tyre ose lidhur me përbajtjen e çdo njoftimi nga Barrëmarrësi se Rasti i Ekzekutimit të Detyrueshëm është vërtetuar apo nuk ekziston më, përveç kur një kërkim, veprim, mbrojtje, përjashtim apo kundër padi mund të behet nga Barrëdhënësi apo Shoqëria në rastin e neglizhencës së rëndë apo sjellje me keqdashje të Barrëmarrësit dhe me qëllimin e vetëm për të kërkuar dëmshpërblimin e çfarëdolloj dëmi të shkaktuar si pasojë e kësaj neglizhencë të rëndë, apo sjelljeje keqdashëse, me kusht që ky kërkim, veprim, mbrojtje përjashtim apo kundërpaditë të mos kenë efekte negative në ushtrimin nga ana e Barrëmarrësit të të drejtës së tyre të parashikuar në paragrafin (a) të këtij neni.

## 7. DEKLARATA DHE GARANCI

### 7.1 Deklarata dhe Garancitë e barrëdhënësve

Barrëdhënësi dhe Shoqëria "Kurum International" SHA, i deklarojnë dhe garantojnë Barrëmarrësin si vijon:

- (a) Barredhenesi është pronar ligjorë i Aksioneve. Nuk ekziston asnjë barrë siguruese apo peng mbi Aksionet, ne favor të të tretëve, përveç Pengut dhe Barrës Siguruese të krijuar nëpërmjet kësaj kontrate;
- (b) nuk janë paraqitur kërkese padi apo pretendime në proces ose Pengdhënësit nuk janë në dijeni për ndonjë kërkësë padi apo pretendim potencial të ngritur përpëra ndonjë gjykate apo paneli arbitrazhi ne Republikën e Shqipërisë apo jashtë saj, lidhur me Kolateralin;
- (c) Shoqëria nuk është në gjendjen e paaftësisë paguese dhe as nuk parashikohet një gjendje e tillë.
- (d) Nuk do te kryhet asnjë zmadhim kapitali me emetim aksionesh të reja apo veprim tjetër që mund të shkaktojë zvogëlimin e pjesëmarrjes së secilit Pengdhënës në kapitalin e Shoqërisë. pa miratimin paraprak me shkrim të Barrëmarrësit.

## 8. ANGAZHIMET

### 8.1 Angazhimi i Pengdhënësve/Barrëdhënësve

Deri në përfundimin e kësaj kontrate në përputhje me këtë nen pengdhënësit/barrëdhënësit me shpenzimet e tyre pranojnë që;

- (a) T'i japid menjëherë dhe të detyrojnë shoqërinë që t'i jape menjëherë Barrëmarrësit të gjitha njoftimet dhe dokumentat e tjera në lidhje me Kolateralin, duke përfshirë, pa kufizim kërkesat e bëra nga palët e treta;
- (b) Të detyrojnë shoqërinë "Kurum International" SHA, të mbajë procesverbale të mjaftueshme dhe t'i mundësojë Barrëmarrësit të drejtën për të bërë kopje të ekstrakteve dhe procesverbaleve;
- (c) Të nënshkruajnë dhe dërgojnë menjëherë të gjitha dokumentat si dhe të marrin të gjithë veprimet e nevojshme apo të këshillueshme në mënyrë që:
- (i) Të regjistrojnë dhe mbajnë në fuqi të plotë pengun dhe të kompletojnë dhe mbajnë në fuqi të plotë Barrën Siguruese për Barrëmarrësin;
  - (ii) Të sigurojnë që mbi të gjitha aksionet e ardhshme dhe të drejtat e shoqërisë të lidhura me to, të nënshkruara nga pengdhënësit të jetë vendosur Peng ose Barrë Siguruese në favor të Barrëmarrësit në përputhje me nenin 2.2 dhe
- (d) Të mos ndryshojnë formën e shoqërisë, përveç kur Barrëmarrësi ka dhënë pëlqimin me shkrim, dhe që ky pëlqim të mos pengohet pa arsy;
- (e) Të mos shesë apo disponojë të gjitha apo pjesë të pronësisë apo të drejtave të kolateralit;
- (f) Të nënshkruajnë, pranojnë dhe të dorëzojnë dokumentat si mund të kërkohet në mënyrë të arsyeshme nga Barrëmarrësi, në mënyrë që t'i sjellë efekte kësaj Kontrate, dhe të paguajë për të gjitha shpenzimet e kërkimit, regjistrimit dhe depozitimit

## 8.2 Përfundimi dhe Çlirimi

Pas përbushjes së Detyrimeve Shoqëria dhe/ose Barredhenesit mund t'i kérkojnë dhe Barrëmarrësi do të jetë i detyruar të konfirmojë brenda 1 (një) muaj pas marrjes së kësaj kërkeze, që Detyrimet janë paguar dhe shlyer totalisht. Përveç kur Barrëmarrësi e njofton Shoqërinë dhe/ose Barrëdhënësit për ndonjë pretendim pezull, kjo Marrëveshje do të zgjidhet dhe Penguin dhe Barra Siguruese do te çlironen nga Barrëmarrësi me këtë konfirmim.

## 9. NJOFTIMET

### 9.1 Adresat

Të gjitha njoftimet sipas kësaj Kontrate apo në lidhje me të do të dërgohen në adresat e deklaruara sipas kësaj marrëveshjeje.

### 9.2 Ndryshimi i Adresës

Secila nga palët mund t'i komunikojë të tjerëve me poste rekomande një tjetër adresë për të gjitha njoftimet.

### 9.3 Forma e Njoftimit

Të gjitha njoftimet apo komunikimet e tjera sipas kësaj Marrëveshje apo në lidhje me të, jepen me shkrim dhe, nëse nuk kërkohet ndryshe edhe nga legjislacioni i zbatueshëm mund të dërgohen me faks. Çdo njoftim i tillë do të konsiderohet se është dhënë nëse faksi është marrë nga marrësi me kusht që njoftimi i dhënë në një ditë jo-pune do të konsiderohet se është marrë ditën pasuese të punës.

## 10. DISPOZITA TE NDYSHME

### 10.1 Ndryshime dhe përjashtime

Asnjë ndryshim apo përjashtim nga dispozitat e kësaj Marrëveshje nuk do të ketë fuqi ligjore përveç rastit kur ai bëhet me miratim me shkrim të Palëve. Barrëmarrësi mund të miratojë zgjatje të afateve kohore dhe lehtësira të tjera, kompromise, pajtime, falje dhe çlirim nga detyrimi ose të merret vesh me shoqërinë lidhur me Kolateralin siç do të gjykohet e përshtatshme prej Barrëmarrësit, pa rënë ndesh me përgjegjësinë e Shoqërisë dhe të Pengdhënësve dhe të drejtat

a detyrimet e Barrëmarrësit sipas kësaj Kontrate apo sipas legjislacionit të zbatueshëm ose ndonjë ligji të zbatueshëm.

#### **10.2 Ndryshime, Transferime, Ripërtëritje**

Kjo Marrëveshje do te jete detyruese për Pengdhënësit dhe Shoqërinë, Barrëmarrësin edhe trashgimtarët e tyre respektive, cesionarët apo të tretët të cilëve u ka kaluar kontrata, edhe në rast te ndryshimit, transferimit apo ripërtëritjes së kontratave të ndryshme ndërmjet palëve apo kësaj Kontrate.

#### **10.3 Transferimet**

As Pengdhënësit, as Shoqëria nuk mund të transferojnë apo kalojnë, tërësisht apo pjesërisht asnjë nga të drejtat e tyre sipas kësaj Kontrate pa miratimin paraprak me shkrim të Barrëmarrësit.

#### **10.4 Rivendosja tërësore e te drejtave**

Të gjithë të drejtat, veprimet dhe përfimet e Barrëmarrësit sipas kësaj Kontrate janë shtesë dhe nuk përashtojnë asnjë të drejte, veprim apo shpërbirim tjetër mbi të cilin Barrëmarrësit kanë të drejta në kuptimin kontraktual (përfshirë pa kufizim ato të Kontratës së Furnizimit) apo në ligj.

#### **10.5 Marrëveshje Siguruese**

Shoqëria dhe Pengdhënësit pranojnë se (a) kjo Kontratë përbën një "Marrëveshje Siguruese" në kuptim të Nenit 2 të Ligjit "Për Barrët Siguruese".

#### **10.6 Garantimi i Interesave te posaçme**

Të gjitha Palët këtu pranojnë dhe konfirmojnë shprehimisht se Pengu dhe Barra Siguruese e krijuar sipas kësaj Kontrate përbën një garanci në favor të Barrëmarrësit, të ndarë dhe pa lidhje me, çfarëdolloj garancie tjetër qe i është dhënë apo do jepet nga Shoqëria ose ndonjë nga aksionarët e Shoqërisë për të siguruar përbushjen e Detyrimeve të Garantuara. Palët këtu bien dakord se Barrëmarrësi ka të drejte të ushtrojë të drejtat e saj që rrjedhin nga kjo Marrëveshje pavarësisht nga të drejtat e saj që rrjedhin nga ndonjë garanci tjetër për shlyerjen e Detyrimeve të Garantuara.

#### **10.7 Ndashmëria**

Dispozitat e secilit prej Neneve dhe paragrafëve të kësaj Kontrate janë të zbatueshme pavarësisht nga njëra –tjetra dhe vlefshmëria e tyre nuk cenohet nëse cilado nga te tjerat është e pavlefshme. Nëse njëra nga dispozitat është nul por do te ishte e vlefshme, nëse pjese e saj do te ishte fshirë, disposta në fjalë zbatohet me ata ndryshime qe mund te jene te nevojshme për ta bëre atë të vlefshme.

#### **10.8 Gjuha e Marrëveshjes**

Kjo kontratë nënshkruhet në 5 (pesë) kopje në gjuhën shqipe, në prani të përkthyesit, një për barrëdhënësit, një për noterin një do të depozitohet në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe 2 (dy) për Barrëmarrësin

#### **10.9 Pranuesit e Kontratës**

Pranuesit e Kontratës deklarojnë se janë dakord me efektet juridike te krijuara nëpërmjet kësaj Kontrate Pengu dhe/ose Barre Siguruese mbi Aksionet dhe vendosjen e Pengut dhe Barrës Siguruese në favor të Barrëmarrësit mbi Aksionet e zotëruara nga Pengdhënësit individë.

#### **11. Verifikimi dhe raportimi i të dhënavë**

Pranuesit e Kontratës deklarojnë se janë dakord me efektet juridike të krijuara nëpërmjet kësaj Kontrate Penguin dhe/ose Barre Siguruese mbi Aksionet dhe vendosjen e pengut dhe Barrës Siguruese në favor të Barrëmarrësit mbi Aksionet e zotëruara nga Pengdhënësit.

## 12 LIGJI I ZBATUESHEM DHE JURISDIKSIONI

### 12.1 Ligji i zbatueshëm

Kjo Marrëveshje rregullohet dhe interpretohet në përputhje me legjislacionin e Republikës së Shqipërisë

### 12.2 Juridiksi

Çdo mosmarrëveshje që mund të ngrihet në lidhje me këtë Marrëveshje do të zgjidhet me mirëkuptim, në rast të kundërt kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjes do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

- Unë noterja, pasi i lexova me zë të lartë palëve këtë marrëveshje, konstatova se palët e gjejnë marrëveshjen në përputhje me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë dhe unë noterja e vërtetoj se e nënshkruajnë Marrëveshjen në përputhje me ligjin.

### PALËT

#### BARRËMARRËS

ALBAMETAL  
MIODRAG JANKOVIC  
Përfaqësuar nga ALTIN HOXHA

Altin Hoxha



#### SHOQËRIA

Shoqëria "Kurum International" SHA  
Përfaqësuar nga YUSUF SEZAI KURUM

Yusuf S. Kurum



Pengdhënës/Barrëdhënës  
z. Hasmet KURUM  
Përfaqësuar nga  
z. Yusuf Sezai KURUM

Hasmet S. Kurum

Elton Asllani




ALMA L. LINANI

POTESER

Reverend

REPUBLIKA E SHQIPERISE  
DHOMA E NOTEREVE TIRANE  
Nr. .... 448 ..... Rep.  
Nr. .... 122 ..... Kol.



Tiranë, më: 09.07.2015

## PROKURË E PËRGJITHSHME

Sot, me datën 09.07.2015 (pesëmbëdhjetë), para meje noteres BLERTA KAÇELI, në Tiranë me zyrë në rrugën Myslym Shyri, Nr. 82, u paraqit personalisht :

**Z. Miodrag JANKOVIC**, shtetas i Republikës së Serbisë, njohës i gjuhës angleze, i biri i Dragolub, i datëlindjes 05.12.1978, lindur në Sremska Mitrovica/Serbi dhe banues në Sremska Mitrovica/Serbi, mbajtës i pasaportës së Republikës së Serbisë Nr. 007619452, dt. 10.07.2009 madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, i cili ne cilësinë e Administratorit dhe Përfaqësuesit Ligjor të Shoqërisë Tregtare "ALBAMETAL" SHPK, me Nr. NIPT-i L43402201R, me seli në adresën: Fshati Bradashesh, Komuna Bradashesh, ndërtesë 3-katëshe, Zona Kadastrale Nr.3965, Pasuria Nr. 952/3, Elbasan, e regjistruar në Regjistrin Tregtar të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit të Republikës së Shqipërisë, sipas legjislacionit shqiptar ne fuqi, i asistuar nga përkthyesi i gjuhës angleze, Z. Dardan MUSTAFAJ, më deklaroi sa më poshtë:

Ai, me vullnetin e tij të lirë dhe të pa vesuar më kërkoi redaktimin e kësaj prokure të posaçme me përbajtjen e mëposhtme :

"Unë i nënshkruari Miodrag JANKOVIC, jam aktualisht administrator dhe përfaqësues ligjor i shoqërisë tregtare "ALBAMETAL" SHPK, me seli në adresën: Ndërtesë 3-katëshe, Zona Kadastrale Nr.3965, Pasuria Nr. 952/3, e regjistruar në Regjistrin Tregtar të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit të Republikës së Shqipërisë, me Nr. NIPT-i L43402201R sipas legjislacionit shqiptar ne fuqi. Me anën e kësaj prokure, në cilësinë e administratorit, **autorizoj Z. Altin HOXHA**, shtetas shqiptar, i biri i Nazif dhe Shadije, i datëlindjes 26.02.1978, lindur në Trebisht –Mucine Dibër dhe banues në adresën: Rr. Aleksandër Goga, Lgj. 15, Spitallë/Durrës, mbajtës i letërnjoftimit shqiptar Nr. 030096979, dhe Nr. Personal H80226006P, i cili të përfaqësojë shoqërinë tregtare "ALBAMETAL" SHPK, në shitjen dhe blerjen e automjeteve dhe makinerive të ndryshme, të përfaqësojë shoqërinë në kryerjen e veprimeve pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, të marrë pjesë në ankande e prokurime publike sipas legjislacionit shqiptar ne fuqi. Për kryerjen e detyrave të mësipërme përfaqësuesi ka të drejtë të kryejë të gjitha veprimet që i konsideron të nevojshme, duke përgatitur përbajtjen që dëshiron dhe nënshkruar në emër te shoqërisë, çdo dokument, procesverbal, marrëveshje, kontrata të ndryshme për realizimin e qëllimit për të cilin i jepet kjo prokurë.

Përfaqësuesi ka të drejtë të përfaqësojë shoqërinë pranë organeve gjyqësore si dhe pranë organeve të tjera administrative shtetërore apo pranë institucioneve publike apo private në Republikën e Shqipërisë. Gjithashtu përfaqësuesi, ka të drejtë të përfaqësojë shoqërinë pranë çdo instituciioni doganor, si dhe të kryejë veprimet përkatëse, apo të nënshkruajë aktet përkatëse pranë tyre.

Përfaqësuesi ka të drejtë të lidhë kontrata pune, kolektive ose individuale, t'i nënshkruajë ato, të zgjidhë marrëdhëni e punës me të punësuarit, të lidhë çdo lloj kontrate, në veçanti kontrata qiraje, shitblerjeje, sipërmarrjeje, shërbimesh. Ndër të tjera përfaqësuesi ka të drejtë të përfaqësojë shoqërinë dhe para organeve gjyqësore e administrative, të nënshkruajë aktet përkatëse, në Republikën e Shqipërisë, për llogari të "Albametal" SHPK.

Përfaqësuesi ka të drejtë të lidhë kontrata të ndryshme, në emër të shoqërisë, të hyjë në marrëdhënie me të tretët, si dhe të bëjë çdo lloj veprimi të nevojshëm.

Përfaqësuesi, ka të drejtë të aplikojë për marrje leje, autorizime, licenca të ndryshme në emër të shoqërisë, pranë institucioneve të ndryshme në Republikën e Shqipërisë, të paraqesë dokumentacionin e nevojshëm teknik apo ligjor etj, deri në marrjen e tyre sipas legjislacionit shqiptar në fuqi.

Nëse është e nevojshme apo kur dhe ai vetë e sheh të nevojshme, përfaqësuesi ka të drejtë të delegoje një pjese apo te gjitha tagrat e dhëna sipas kësaj prokure personave të tretë. Për këtë qëllim ai ka të drejtë që nëpërmjet një autorizimi të shkruar të autorizojë në emër të shoqërisë persona të tjerë për kryerjen e veprimeve specifike.

Kjo prokurë lëshohet pa afat dhe është e vlefshme deri në shfuqizimin e saj nga ana ime apo kur vetë përfaqësuesi heq dorë prej saj.

Me kete Prokurë shfuqizoj në gjithe tërësinë e saj Prokuren Nr. 165 REP dhe Nr. 30 KOL datë 15.12.2014 (notere Blerta Kaçeli) dhe z. Arta PJETËRNIKAJ nuk është më përfaqësuesi i shoqërisë tregtare "ALBAMETAL" SHPK.

Çdo veprim juridik te kryer prej tij pas kësaj Prokure, unë e konsideroj absolutisht të pavlefshëm dhe pa asnjë pasojë juridike.

Ky akt pasi u redaktua në 5 (pesë) kopje prej meje noteres, ju përkthye në gjuhën angleze të interesuarit, zotruies i kësaj gjuhe, i cili e dëgjoi e miratoi dhe nënshkroi atë në prezencën time. Ky akt u përkthye prej përkthyesit Z. Dardan Mustafaj, i biri i Besnik, lindur më dt. 26.07.1984, në Tiranë dhe banues në Tiranë, Rr. Ded Gjo Luli, P5, shk 3/36 Tirane, i njohur prej meje noteres prej letërnjoftimit Nr.024474721, dt.03.03.2009, me zotësi të plotë për të vepruar, i cili zotron gjuhën angleze dhe nënshkroi në prezencën time.

Akti nënshkruhet dhe prej meje noteres.

I PËRFAQËSUARI

Administrator i Shoqërisë  
"ALBAMETAL" SHPK

Z. Miodras Jankovic'

Përkthyesi: Z.

Dardan Mustafaj

NOTERI

BLERTA KAÇELI

Blerta Kaçeli

ut 10.07.2010

РАДИНА

из 09. XII. 10

18.01.11 87

ЛОГ ЈУГИ

09. XII. 10

БЛГОВИЦИ

из 14. VIII. 11  
БЛГОВИЦИ

РЕПУБЛИКА СРБИЈА

REPUBLIC OF SERBIA

REPUBLIQUE DE SERBIE

ПАСОШ  
PASSPORT  
PASSEPORT

P  
SRB  
JANKOVIC

MODRAG

SRPSKO

007619452

0512978890033

05.12.1978

SRPSKO

REPUBLIKA E SHQIPERISE  
DHOMA E NOTEREVE Tiranë  
Nr. 255 REP  
Nr. 74/4 KOL



Tirane, me: 16/02/2016

### PROKURË

Sot, me datën 16.02.2016, para meje Noterit Belinda ÇELAJ, anëtare e Dhomës se Noterisë Tirane, u paraqit personalisht shtetas i mëposhtëm :

z. Hasmet Bedii KURUM, shtetas shqiptar, i biri i Salim Sitki, i datëlindjes 27.12.1960, lindur ne Ercis/Turqi dhe banues ne Tirane, mbajtës i letërnjoftimit Nr. 028512298, dhe Nr. Personal G01227031Ri cili njëkohësisht është dhe aksionar i vetëm ne shoqërinë tregtare "Kurum International" SHA, me seli në adresën: Rruga "Ibrahim Rugova", Pallati Nr.14 KT, "Green Park", Apartamenti Nr.39, kati 6, Tiranë e regjistruar në Regjistrin Tregtar të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit të Republikës së Shqipërisë, me numër NIPT K02727230T,

Z. Hasmet Kurum, me vullnetin e tij te lire dhe te pote deklaro si me poshtë :

Unë i nënshkruari Hasmet KURUM, jam aktualisht Aksionar i Vetëm i shoqërisë tregtare "KURUM INTERNATIONAL" SHA, shoqëri tregtare regjistruar pranë Qendrës Kombëtare te Regjistrimit me Nr. K02727230T, me seli ne Elbasan ne adresën : Ish Kombinati Metalurgjik, Komuna Bradasesh. Me anë të kësaj prokure emëroj si përfaqësuesin tim të posaçëm z. Yusuf Sezai KURUM, i datëlindjes 10/08/1980, shtetas Turk, mbajtes I pasaportes turke me nr U 01215069, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar, i cili te me përfaqësoje mua personalisht "Kurum International" sha, për nënshkrimin e kontratës përkatëse te furnizimit ndërmjet "ALBAMETAL" SHPK, "Kurum International" SHA dhe Hasmet KURUM për vënie peng dhe vënie si barrë siguruese mbi të gjitha aksionet e mia që zotëroj pranë shoqërisë "Kurum International" SHA. Për këtë gjë, ai ka të drejtë të nënshkruajë aktet përkatëse pranë noterit, të paraqitet pranë noterit dhe te pajiset me pas me një kopje te kontrates. Gjithashtu, përfaqësuesi im ka të drejtë të nënshkruajë çdo lloj akti lidhur me vënien peng dhe lënje si barrë siguruese të të gjitha aksioneve që unë zotëroj pranë "Kurum International" SHA

Kjo prokurë mbaron pas realizimit të qëllimit për të cilën është dhënë ose kur vetë i përfaqësuari heq dorë prej saj.

Për efekt te ligjit, konform neneve përkatëse të Kodit Civil, unë noteri lëshoj këtë prokurë të posaçme, e cila pasi iu lexua dhe u gjend sipas vullnetit të tij të lire dhe të plotë, u nënshkrua prej tij dhe u vërtetua prej meje sipas ligjit.

DEKLARUESI  
HASMET KURUM

Hosnaf Bedi  
Kurum

NOTERE  
Belinda ÇELAJ  
NOTERE  
BELINDA ÇELAJ  
CEP: 0692077176

**VENDIM datë 15.02.2016  
I ASAMBLESË SË PËRGJITHËSHME TË  
SHOQËRISË TREGTARE  
"ALBAMETAL" SHPK**

Sot, në datën 15.02.2016, në Elbasan, në selinë e shoqërisë, po zhvillohet mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë Tregtare "ALBAMETAL" SHPK (shoqëri tregtare e regjistruar sipas legjislacionit shqiptar në fuqi me seli në adresën: Lagja "28 Nëntori", Bulevardi "Qemal Stafa", pallati Nr.109/1, shkalla 1, kati 2, Elbasan, me NIPT L43402201R), me rend dite.

**Rendi i ditës së Mbledhjes është:**

- Miratimi i kontratës kuadër te furnizimit me shoqerinë "Kurum International" SHA;
- Pranimin e garancive të ofruara nga ana e "Kurum International" SHA;
- Caktimin e personave përgjegjës që do të merren me zbatimin e këtij vendimi dhe akteve e kontratave lidhur me Kurum International SHA;

Ortak i vetëm i Shoqërisë Tregtare "ALBAMETAL" SHPK është Shoqëria Tregtare "NOVOMETAL" DOO -VETERNIK, e cila në këtë mbledhje, përfaqësohet nga z. Çagatay URAZ. Në këtë mbledhje, z. Çagatay URAZ, asistohet nga përkthyesi i gjuhës turke, z. Elton ASLLANI.

Ortaku i vetëm i shoqërisë, pasi u njoh me rendin e ditës, i mbledhur në formën e Asamblesë së Përgjithshme,

Kosntaton se:

- A. Kompania "Kurum International" SHA, (si "E Furnizuar"), dëshiron të hyjë në një Marrëveshje Kuadër Furnizimi (këtu e më pas "Marrëveshja") me shoqerinë tregtare "ALBAMETAL" SHPK dhe pranon që të marrë furnizime mallrash dhe shërbimesh dhe për qëllime të zbatimit të kësaj marrëveshje, pranon që lë lërë hipotekë të radhës së dytë dhe të lërë peng ose barrë siguruese të gjitha aksionet që zotërohen nga Aksionari i vetëm z. Hasmet Bedii KURUM.
- B. Vetë kompania "ALBAMETAL" SHPK, dëshiron të hyjë në një marrëveshje të tillë me "Kurum International" SHA (subjekt tatimpagues me Nr. K 02727230 T NIPT –i, me seli në Tiranë, në adresën: Rruga "Ibrahim Rugova", Pallati Nr.14 KT, "Green Park", Apartamenti Nr.39, kati 6);
- C. Vetë shoqëria "Kurum International" SHA, ka pranuar që për garantimin e detyrimeve që dalin nga "Marrëveshja", lë si hipotekë të radhës së dytë, pasuritë e paluajtshme që ajo zotëron, dhe që ndodhen të regjistruala pranë Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Mat, Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Kurbin dhe Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Sarandë.
- D. Vetë shoqëria "Kurum International" SHA ka pranuar që përveç sa më sipër të lërë peng dhe/ose si barrë siguruese të gjitha aksionet që zotërohen nga z. Hasmet Bedii KURUM;

02  
Dy

E. Vetë z. Hasmet Bedii KURUM është shprehur i gatshëm t'i lërë këto aksione peng ose si barrë siguruese në dobi të Albametal SHPK për qëllime të zbatimit të marrëveshjes kuadër

Pas shqyrtimit të rendit te dites

Aksionari i Vetëm i mbledhur në formën e Asamblesë së Përgjithëshme të Ortakëve, vendos si më poshtë:


**VENDIM**

1. Miratimin per shqyrtim të rendit të ditës;
2. Shoqëria "ALBAMETAL" SHPK të hyjë në marrëdhënie furnizimi dhe për këtë fakt pranohet Kontrata Kuadër që do të lidhet me Kurum International SHA në cilësinë e të furnizuarit dhe Albametal SHPK në cilësinë e Furnizuesit
3. Pranimin e garancisë së "Kurum International" SHA për lejimin e dhënies hipotekë të radhës së dytë të pasurive të paluajtshme në emër të "Kurum International" SHA, të cilat janë të regjistruara pranë Zyrës Vendore të Rëgjistrimit të Pasurive Mat, Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtëshme Kurbin dhe Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtëshme Sarandë, në dobi të "ALBAMETAL" SHPK.
4. Pranimin e garancisë së ofruar nga "Kurum International" SHA dhe z. Hasmet Bedii KURUM (aksionar i vetëm i "Kurum International" SHA, për lënien peng të të gjitha aksionëve të "Kurum International" SHA në dobi të "ALBAMETAL" SHPK).
5. Urdhërohet nënshkrimi i kontratave përkatëse në zbatim të legjisacionit shqiptar në fuqi nga "ALBAMETAL" SHPK.
6. Autorizohet z. Altin HOXHA, shtetas shqiptar, i biri i Nazif dhe Shadije, i datëlindjes 26.02.1978, lindur në Trebisht –Mucine Dibër dhe banues në adresën: Rr. Aleksandër Goga, Lgj. 15, Spitallë/Durrës, mbajtës i letërnjoftimit shqiptar Nr. 030036979, dhe Nr. Personal H80226006P, i cili të përfaqësojë shoqërinë tregtare "ALBAMETAL" SHPK, të nënshkruejë të gjitha aktet përkatëse lidhur me zbatimin e këtij vendimi, si dhe të përfaqësojë shoqërinë "ALBAMETAL" SHPK, për nënshkrimin e Kontratave Kuadër të Furnizimit me "Albametal SHPK", pengut, hipotekës si dhe çdo kontratë tjeter të nevojshme si dhe të bëjë aplikimet përkatëse.
7. Ky vendim të depozitohet pranë organeve përkatëse të nevojshme nëse kërkohet

**ASAMBLEJA E PËRGJITHËSHME  
ORTAKU I VETËM  
"NOVOMETAL" DOO, VETERNIK**

Përfaqësuar nga  
z. Çagatay URAZ

*ÇAGATAY URAZ*  
*Elton ASLLANI*



**VENDIM I**  
**AKSIONARIT TË VETËM TË SHOQERISE**  
**"KURUM INTERNATIONAL" SHA**

Sot, në datë 16.02.2016, i poshtëshënuari, z. Hasmet KURUM, shtetas i Republikës së Shqipërisë, lindur në Ercis/TURQI, në datë 27.10.1960, mbajtës i pasaportës shqiptare Nr. SI2754602, në cilësinë e Aksionarit të Vetëm të Shoqërisë Tregtare "Kurum International" SHA, një shoqëri tregtare e organizuar që operon në përputhje me ligjet e Republikës së Shqipërisë në fuqi, regjistruar pranë Regjistrat Tregtar në 07.07.2000, me seli në: Rruga "Ibrahim Rugova", Pallati Nr.14 KT, "Green Park", Apartamenti Nr.39, katë 6, Tiranë, me Kod Fiskal K02727230T (këtu e më pas referuar si "Kompania") në përputhje me rregullat e zhvillimit dhe realizimit të një mbledhjeje, vuri në dukje dhe vendosi si më poshtë:

**NDËRSA**

- A. Kompania "Kurum International" SHA, (në cilësinë "E Furnizuar"), dëshiron të hyjë në një Marrëveshje Kuadër Furnizimi (këtu e më pas "Marrëveshja") me shoqërinë tregtare "ALBAMETAL" SHPK (shoqëri tregtare e regjistruar sipas legjislacionit shqiptar në fuqi me seli në adresën: Lagjja "28 Nëntori", Bulevardi "Qemal Stafa", pallati Nr.109/1, shkalla 1, katë 2, Elbasan, me NIPT L43402201R) dhe pranon që të marrë furnizime mallrash dhe shërbimesh dhe për qëllime të zbatimit të kësaj marrëveshje, pranon që lë lërë hipotekë të radhës së dyte dhe tw lrrw peng ose barrw siguruese tw gjitha aksionet qw zotërohen nga Aksionari i vetëm z. Hasmet KURUM.
- B. Me qëllim zbatimin e pikave të përmendura në gërmën A sa më sipër, është parashikuar që Kompania të hyjë në këtë marrëveshje kuadër furnizimi, e cila do të konsiderohet "Marrëveshja"
- C. Përveç rasteve kur përcaktohet ndryshe këtu dhe përveç kur konteksti e kërkon ndryshe, të gjitha termat dhe shprehjet, të cilat janë të përcaktuara në Marrëveshjen do të kenë të njëjtin kuptim kur përdoren në këtë vendim.

Pas shqyrtimit të rendit të ditës;

Aksionari i Vetëm i mbledhur në formën e Asamblesë së Përgjithëshme, vendos si më poshtë::

**VENDIM**

1. Miratimin e rendit te dites
2. Aprovimi dhe konfirmimi i negociatave (bisedimet) të kompanisë "Kurum International" SHA, për Marrëveshjen Kuadër të Furnizimit me shoqërisë "ALBAMETAL" SHPK, ku kompania jonë do të jetë në cilësinë e të furnizuarit.
3. Lejimin e dhënies hipotekë të radhës së dyte të pasurive të paluajtshme në emër të "Kurum International" SHA, të cilat janë të regjistruara pranë Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive Mat, Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Kurbin dhe Zyrës Vendore të

- Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Sarandë.
4. Pranimin dhe lënien peng dhe/ose barrë siguruese të të gjitha aksioneve të "Kurum International" SHA.
  5. Lejimin e dhënies peng dhe/ose si barrë siguruese të të gjitha aksioneve që z. Hasmet KURUM, zoteron tek shoqëria "Kurum International" SHA, sipas legjisacionit shqiptar ne fuqi dhe nënshkrimi i kontratave përkatëse lidhur me to;
  6. Autorizohet z. Yusuf Sezai KURUM, shtetas Turk, mbajtës i pasaportës Turke me Nr. U01215069, lindur në Ercis/Turqi, i datëlindjes 10.081982, të nënshkruajë të gjitha aktet përkatëse lidhur me zbatimin e këtij vendimi, si dhe të përfaqësojë shoqërinë "Kurum International" SHA, për nënshkrimin e Kontratave Kuadër të Furnizimit me "Albametal SHPK", pengut si dhe çdo kontratë tjeter të nevojshme si dhe të bëjë aplikimet përkatëse.

Aksionari i Vetëm i  
**KURUM INTERNATIONAL SHA**  
**Z. HASMET KURUM**  
  
(Emër, Mbështetje Nënshkrimi)


# Regjistri i Barrëve Siguruese



Rr. e Dibres, Gencra e Sazës: AK  
"Selvia", Kati V  
TIRANE, SHQIPERI  
TEL/FAX: 355 4 2420005  
TEL: 355 4 2420006  
Email: rbs@rcen.al.com

## REZULTATET E KËRKIMIT

Numri i Rezultatit te Kerkimit: D-20160216171442375  
Data e Rezultatit te Kerkimit: 16.02.2016  
Ora e Rezultatit te Kerkimit: 17:14:42PM  
Lloji i Kerkimit: D-400-045-6141  
Numri i Dokumentit: 0  
Referencia e Perdoruesit:



## LISTA E PERSONAVE ME REZULTAT KERKIMI 0

HASMET BEDII SALIM SITKI KURUM



*Taremi JY*

### REZULTATET E KËRKIMIT

#### INFORMACION I PËRGJITHSHËM :

Numri i Rezultatit të Kërkimit:	D-20160216162120593
Data e Rezultatit të Kërkimit:	16.02.2016
Ora e Rezultatit të Kërkimit:	4:21:20PM
Lloji i Kërkimit:	Emri i Personit Juridik
Kriteri i Kërkimit:	(EM) KURUM INTERNATIONAL SH.A.
Numri i Dokumentit:	D-400-045-6142
Referencia e Përdoruesit:	

#### NUMRI I REZULTATEVE TE GJETURA SIPAS :


 (EM) KURUM INTERNATIONAL SH.A.      ËSHTË 7

---

REGJISTRIMI -	A-20080129135609187
Data e regjistrimit	29.01.2008
Ora e regjistrimit	1:56:09PM
Kohëzgjatja e Regjistrimit (vite):	25
Data e Përfundimit të Regjistrimit:	29.01.2033
Numri i Dokumentit:	A-503-001-27
